REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 326/3 Prot. Vlorë më, 22. 02. 2019

**VENDIM**
**Nr. 8, datë 22. 02. 2019**

**PËR**
**PËRCAKTIMIN E MASËS E SHPËRBLIMIT FINANCIAR TË ANËTARËVE TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT DHE SENATIT AKADEMK**

Mbështetur në neni 49 pika 1, gërma a,ë, të Ligjit Nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"* VKM-së nr.329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", neni 18, dhe Vendimin nr. 656, datë 31. 10. 2018, të Këshillit të Ministrave *"Për përcaktimin masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të Qeverisjes Qëndrore"* pika 5, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 22.02. 2019

**VENDOSI**

1. Masa e shpërblimit mujor për Kryetarin e Senatit Akademik të jetë 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekë.
2. Masa e shpërblimit mujor për anëtarët e Senatit Akademik të jetë 23.000 (njëzetë e tre mijë) lekë.
3. Masa e shpërblimit mujor për Kryetarin dhe Anëtarët e Bordit të Administrimit të jetë 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekë.
4. Masa e shpërblimit mujor për Sekretarin e Bordit të Administrimit për punën në mbështetje të aktivitetit të Bordit të Adminstrimit të jetë 10.000 (dhjetë mijë) lekë. Ky shpërblim t'i shtohet pagës mujore që ai përfiton në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë
5. Anëtarëve të Bordit të Administrimit si dhe Sekretarit, të cilët udhëtojnë Brenda ose jashtë vendit të tyre të punës për mbledhjet e Bordit t'u rimbursohen shpenzimet e udhëtimit, fjetjes si dhe trajtime të tjera ( dieta, hotel, bileta etj)
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë
7. Çdo vendim i mëparshëm shfuqizohet.
8. Ky vendim hyn në fuqi nga 1 Mars 2019.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Dr.Rezana Vrapi- Kryetare

Florian Nurce- Anëtar

Ornela Koleka- Anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj- Anëtar

Dr. Enida Pulaj- Anëtar

Dr. Marinela Muço- Anëtar

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Ëeb-site: ëëë.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al